



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 28

Tiranë – E hënë, 18 shtator 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së nr. 3565, datë 24.7.2017	Ndaj subjektit fizik/juridik “Ritvan Rama”, protokolluar me nr. 1661 prot., datë 10.4.2017..... 3
Vendim nr. 411(64-2017-1074), datë 19.6.2017	Me objekt kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit për shoqërinë tregtare Balkan Company sh.p.k., Lushnjë..... 3
Kërkesë e Agjencisë së Trajtimit të Pronave nr. 8073, datë 7.9.2017	Për publikim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të regjistrit të vendimeve, të cilët kanë njohur të drejtën për kompensim dhe vlerësimet për vitin 1993, 1994 dhe 1995..... 8

**VENDIM****Nr. 3565, datë 24.7.2017****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 9, datë 21.3.2017, të ISHMP-së Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit fizik/juridik “Ritvan Rama”, protokolluar me nr. 1661 prot., datë 10.4.2017.

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 137, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisionit i ankimit:

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit me gjobë në vlerën 300.000 lekë, nr. 9, datë 21.3.2017, të ISHMP Dega Rajonale Tiranë, rrëzimin e ankimit të subjektit “Ritvan Rama” ndaj këtij vendimi administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë!

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë

VENDIM**Nr. 411 (64-2017-1074), datë 19.6.2017****NË EMËR TË REPUBLIKËS****GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
LUSHNJË, E PËRBËRË PREJ:

Gjyqtare: Saemira Hila,
asistuar nga sekretare e seancës Ina Gjyla, në
Lushnjë, sot në datën 19.6.2017, në seancë

gjyqësore me dyer të hapura, mbaroi së shqyrtuari dhe shpalli vendimin përfundimtar në çështjen civile nr. 21/143 (973) Regj. Them., me palë:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (DRT), përfaqësuar nga juristët Ervisa Shabani ose Endrit Latifaj, caktuar me autorizim të posaçëm nr. 1886/2, datë 13.12.2016, nga drejtuesi i institucionit, legjitimuar në zbatim të nenit 96, germa “c”, pg. i fundit i KPC-së.

PERSONI I TRETË: Shoqëria tregtare Balkan Company sh.p.k., me NIPT: L1372525402U, me administrator z. Klejdi Toshkëzi, me seli në Lushnjë, lagjja “Loni Dharmo” (në mungesë njoftuar me shpallje publike).

OBJEKTI: Kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit për shoqërinë tregtare Balkan Company sh.p.k., Lushnjë.

BAZA LIGJORE: Neni 104/c i ligjit 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008; KC; KPC.

Gjykata, pasi dëgjoi palët dhe analizoi provat e marra gjatë hetimit gjyqësor, ftoi palët në konkluzionet përfundimtare, ku palët kërkuar:

- *Përfaqësuesi i palës kërkuese përfundimisht kërkoj – pranimin e kërkesës. Vazhdimin e procedurës së falimentit për shoqërinë tregtare Balkan Company sh.p.k. Lushnjë.*

- *Personi i tretë: I deklaruar në mungesë dhe i njoftuar me shpallje publike.*

Gjykata, pasi analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Se pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, fillimisht, me kërkesën me objekt dhe shkak ligjor si më lart, për çeljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë Balkan Company sh.p.k.

2. Siç rezulton nga ekstraktet e lëshuara nga QKB-ja, akte të cilat u administruan në gjykim, shoqëria Balkan Company sh.p.k. është një person juridik tregtar, subjekt i së drejtës tregtare shqiptare, i krijuar dhe i regjistruar konform ligjit të kohës, në datën 15.1.2011, në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Në ekstrat është përcaktuar qartë selia e kësaj shoqërie: Fier. Lushnjë, lagjja “Loni



Dhamo”, përballë “Bar Bullica”, e cila në vijim nuk është ndryshuar.

3. Kapitali themeltar: në vlerën 100.000.00 lekë. Objekti i veprimtarisë tregtare: “Import eksport mallrat e ndryshme industriale, si materiale ndërtimi, tekstile, kimike, mekanike e të tjera të këtij lloji. Tregti me shumicë e pakicë të artikujve industrialë dhe ushqimorë. Punime të ndryshme ndërtimi. Prodhim i materialeve të ndryshme të ndërtimit.”

4. Përfaqësues ligjor i shoqërisë Balkan Company sh.p.k. është z. Klejdi Toshkëzi, me afat të emërimit të tij, nga data 15.1.2011 deri në datën 15.1.2016. Ortakë të shoqërisë janë: 1. Giuseppe Serena, me kuotë pjesëmarrjeje në kapitalin e shoqërisë 25,00 pjesë ose në masën 25 %; 2. Francesco Toschi me kuotë pjesëmarrjeje në kapitalin e shoqërisë 25,00 pjesë ose në masën 25 %; si edhe 3. ortakut i fundit, Klejdi Toshkëzi me kuotë pjesëmarrjeje në kapitalin e shoqërisë 50,00 pjesë ose në masën 50%.

5. Sipas pohimeve të palës kërkuese, veprimtaria e shoqërisë ka rezultuar me humbje të kapitaleve tri vite rresht dhe, konkretisht në vitet 2012, 2013, 2014, kjo për shkak të vështirësive financiare që ka kaluar ky subjekt tregtar. Ndodhur në këto kushte, sipas palës kërkuese, situata financiare e saj për shkak të humbjeve ekonomike, ka pas sjellë mbingarkesën e detyrimeve dhe paaftësi paguese të detyrimeve, si ndaj shtetit ashtu edhe ndaj të tretëve. Gjendja financiare e përkeqësuar e parashtruar nga pala kërkuese ka diktuar dhe paraqitjen në gjykatë të kërkesës së saj për hapje të procedurës së falimentimit në cilësinë e debitorit. Fillimisht DTR Fier është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo e fundit me vendimin nr. 1025 (4119), datë 30.9.2016 ka shpallur moskompetencën tokësore, duke e dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në bazë të neneve 3 dhe 4 të ligjit “Për falimentimin”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pas ardhjes së dosjes nga Gjykata tjetër, vlerësoi se është gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës për hapje të procedurës së falimentimit, si Gjykata e vendit ku ka selinë dhe ushtron aktivitetin shoqëria tregtare për të cilën kërkohet edhe nisja e procedurës së falimentimit.

6. Neni 13, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar e aktualisht i shfuqizuar) parashikon shprehimisht: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak; 2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i

paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat.

3. Nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori, paaftësia paguese në një të ardhme të afërt përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese në një të ardhme të afërt, kur nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyej detyrimet që ka në datën e maturimit. 4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë. Procedurat për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës. 5. Kriteret dhe mënyrat e përllogaritjes së treguesve ekonomikë, mbi të cilët fillojnë procedurat e falimentimit, caktohen nga Këshilli i Ministrave”.

7. E drejta e palës kërkuese, për t’iu drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt: hapje të procedurës së falimentimit gjen mbështetje në nenin 14/1 të ligjit “Për falimentimin” sipas të cilit: “1) Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare”.

8. Në ligj bëhen rregullime të posaçme në varësi dhe të statusit (debitor apo kreditor) të subjektit që paraqet kërkesën për falimentimin. Në nenin 14 të ligjit “Për falimentimin” përcaktohet shprehimisht dokumentacioni i kërkuar nga ligji që duhet t’i bashkëngjitet kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, në rastin kur kërkesa parashtrohet nga organi tatimor, sikundër rasti konkret. Më konkretisht citojmë nenin 14.1/2 të ligjit: “1/2. Organet tatimore përjashtohen nga pagimi i taksave gjyqësore. Për fillimin e procedurës së falimentimit organet tatimore paraqesin në gjykatë:

- a) kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit;
- b) dokumentacionin e shoqërisë (statutin, aktin e themelimit, numrin e NIPT-it);
- c) bilancin me pasqyrat financiare të shoqërisë, për të cilin kërkohet fillimi i procedurës së falimentimit”.

9. Në rastin objekt gjykimi pala kërkuese, e paraqitur, bashkë me kërkesën për hapje të procedurës së falimentimit ka sjellë në gjykatë midis



të tjerave dhe çka kërkohet në nenin 14 të ligjit: *Pasqyrat financiare dhe bilanci e shoqërisë Balkan Company sh.p.k., për vitet 2012, 2013 dhe 2014. Në këto pasqyra financiare jepen pasuritë (inventarët e ndryshëm), përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra të debive dhe kredive etj.*

10. Pala kërkuese në tërësinë e dokumenteve të paraqitura, ashtu sikurse parashtrohet në shpjegimet e saj, kërkon të provojë se plotëson kërkesat e ligjit “Për falimentimin”, duke parashtuar si shkak faktin se, personi i tretë ka rezultuar në mënyrë të pandërprerë me një bilanc ekonomik me humbje për më shumë se tri vite radhazi. Një fakt i tillë sipas palës kërkuese, dikton pamundësinë e personit të tretë për të marrë pjesë në vazhdim në qarkullimin civil si subjekt tregtar, kjo edhe për shkak të cenimit të interesave të ligjshme të kreditorëve eventuale të kësaj shoqërie e mbi të gjitha të shtetit. Ndër shkaqet për hapjen e procedurës së falimentimit, veç humbjeve në vijimësi, është *insolvabiliteti* ose gjendja e *paafësisë* paguese të personit të tretë. Gjendja e paafësisë paguese, nga pikëpamja e ligjit mbi falimentin, përbën një shkak të përgjithshëm dhe, me të, ligji lidh një nga mundësitë potencialisht të mjaftueshme për hapjen e procedurave të falimentimit.

11. Për të vlerësuar sa pretendon dhe parashtrohet pala kërkuese, pas paraqitjes dhe të dokumentacionit të kërkuar nga ligji, Gjykata vendosi, në përputhje me nenin 18 të ligjit “Për falimentimin”, në relacion me nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, të emërojë një specialist ekspert, duke e ngarkuar me disa detyra në vështrim të asaj çka parashikon kjo dispozitë e ligjit të posaçëm mbi falimentimin. Gjykata caktoi si ekspert z. Rrapo Xhaferraj, i cili është i licencuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, me nr. 22 licence, datë 1.7.2015 e vlefshme deri në datë 1.7.2017. Eksperti Rrapo Xhaferraj, pasi u njoh me të gjithë dokumentacionin e paraqitur në gjykatë nga pala kërkuese, në përputhje me ligjin në fuqi, si dhe me detyrat e lëna, paraqiti një raport vlerësimi, i cili iu nënshtrua hetimit gjyqësor. Në këtë raport-vlerësimi përcaktohen detyrat e lëna dhe përgjigjet e pyetjeve në lidhje me to në mënyrë të detajuar.

12. Më konkretisht, sipas ekspertit të licencuar në fushën e administrimit të falimentimit, është

konkluduar lidhur me detyrat e caktuara nga Gjykata në vështrim të nenit 18 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, se: “Pra rezultoi se ka një paafësi paguese për periudhën deri më 31.12.2015 e në vazhdim. Kjo përbën shkak të përgjithshëm për fillimin e procedurës së falimentimit. Por, siç provohet nga këto pasqyra, kjo llogaritje është bërë sipas standardeve të administrimit të masës së falimentimit dhe se kjo shoqëri në rast likuidimi nuk del me tepriçë pozitive për t’u shpërndarë ortakëve, pasi janë hequr pagesat e kreditorëve. Por duke parë gjendjen në bankë dhe arkë 0 (zero) lekë, del se kjo shoqëri nuk ka afësi paguese të paguaj detyrimet e procedurës së falimentimit dhe të shpërbërimit të administratorit të përkohshëm. Treguesit e mësipërm ekonomiko-financiarë japin një pamje të drejtë dhe analitike të situatës ekonomiko-financiare të kësaj shoqërie për t’u përgjigjur pyetjeve të gjykatës, të cilat janë: 1. Të verifikoj nëse është real shkak për hapjen e procedurës së falimentimit. Kërkesa e DRT Fier për hapjen e procedurës së falimentimit për “Balkan Company” sh.p.k., duke parë paafësinë paguese, e cila vërtetohet se ekziston, është e bazuar, pasi nuk ka mundësi të kryejë pagesat në datën e maturimit, si dhe detyrimet deri në datën 31.12.2015, si dhe pagesat në periudhat e ardhshme. Përgjigje: Kjo përbën shkak të përgjithshëm, prandaj kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit është e bazuar në provat e mësipërme dhe në gjendjen ekzistuese likuiduese nuk mund të paguajë detyrimet në datën e maturimit. 2. Të verifikoj nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit. Ashtu si vërtetohet edhe nga pasqyrat financiare të shoqërisë për të gjitha periudhat e veprimtarisë së saj të deklaruar pranë DRT Fier, kjo shoqëri nuk ka asetë (aktive afatgjata materiale) që të mbulojë shpenzimet e procedurës së falimentit që në kuptim të neneve 33 dhe 170, të ligjit të falimentit përbën masën e falimentit, është me tregues negativ dhe në këto rrethana dubet të ndërpritet procedura e falimentimit për mungesë të pasurive në masën e falimentimit. Përgjigje: Provohet se pasuritë e debitorit nuk mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit që llogariten në shumën prej 60.000 lekësh me TVSH, bazuar në VKM-në nr. 197, datë 13.4.2007 “Për masën e shpërbërimit të administratorit të falimentimit dhe rimbursimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit.”

13. Në përfundim, siç përshkruam edhe më lartë kjo shoqëri nuk ka një aktivitet dhe nuk është e mundur të vazhdojë aktivitetin për të cilin është themeluar dhe nuk ka ndonjë provë për mundësinë e vazhdimit të aktivitetit nga debitori.



Eksperti ka konkluduar gjithashtu edhe në lidhje me pamundësinë e vazhdimet të aktivitetit tregtar të shoqërisë si për shkak të paaftësisë paguese, ashtu edhe për shkak të humbjeve ekonomike në më shumë se tri vite rresht, por nga ana tjetër eksperti e ka shtrirë veprimtarinë e tij verifikuese e konkluduese, tej periudhës kohore për të cilën pala kërkuese ka ngritur pretendimet e saj. Në analizë të aktit të ekspertimit “Raport vlerësimi”, të hartuar nga ana e ekspertit Rrapo Xhaferraj, Gjykata konstaton se shoqëria, person i tretë në gjykim, nuk ka mundësi për të gjeneruar të ardhura që mund të përmirësojnë treguesit e saj ekonomikë apo aftësinë paguese të saj. Në fund të raportit të vlerësimit eksperti përmbledh se ***bazuar në nenin 18, pika 4/b, të ligjit të falimentimit, kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit duhet të rrëzohet për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.***

14. Ky konkluzion i ekspertit Rrapo Xhaferraj nuk harmonizohet me provat e tjera të marra në këtë gjykim, me pohimet gjyqësore dhe me kërkimet e palës kërkuese DRT Fier. Nga ana e palës kërkuese, nëpërmjet përfaqësuesit të saj të posaçëm u pohua gjyqësisht fakti se shoqëria Balkan Company sh.p.k., duhet të çelte procedurat e falimentimit, pasi për një periudhë për më shumë se tre vjet ka rezultuar me bilanc negativ në aktivitetin tregtar të saj, me humbje ose në termat e ligjit, pasiv.

15. Nisur nga sa më lart, mbështetur në provat e paraqitura nga pala kërkuese dhe në kundërshtim konkluzionin e arritur nga eksperti në raportin e vlerësimit të tij Gjykata çmon se, në kushtet kur ekziston shkak real për hapjen e procedurës së falimentimit; kur shoqëria tregtare Balkan Company sh.p.k. nuk mbulon detyrimet ndaj të tretëve në shumën prej 295.266 lekësh, ndërkohë që nga pasqyrat financiare rezulton se humbja në kapital është mbuluar po nga ortakët e saj dhe nuk është shtuar në kapital për mbulimin e humbjeve, si edhe në kushtet kur ortakët e shoqërisë nuk kanë deklaruar kapitalin fillestar si edhe nisur nga fakti që eksperti ka marrë në shqyrtim edhe vitin fiskal 2015, vit i cili nuk është objekt i kërkesës për falimentin, Gjykata vlerëson se duhet të konkludojë në favor të pranimin të kërkesës dhe në kundërshtim me konkluzionin e

ekspertit Rrapo Xhaferraj, sipas nenit 224/b, pg.II, të KPC-së.

16. Gjykata konkludon se duhet të pranohet kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit, duke pasur parasysh këtu dhe të gjitha kërkesat e ligjit, në lidhje me pasojat juridike të hapjes së procedurës së falimentimit dhe konkretisht: Caktimin e administratorit të falimentimit, publikimet përkatëse, të drejtat e kreditorëve të shoqërisë etj. Gjykata çmon të caktojë si administrator të falimentimit nga lista e ekspertëve të licencuar në këtë fushë, z. Rrapo Xhaferraj, i licencuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, me nr. 22 licence, datë 1.7.2015, e vlefshme deri në datën 1.7.2017, me adresë: “Hajro Çakëri”, rruga “Sulejman Delvina”, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

17. Përfundimisht, për sa u argumentua më lart, duke e konsideruar të mbështetur në ligj e prova, Gjykata çmon të disponojë me pranimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë Balkan Company sh.p.k., Lushnjë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, në bazë të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, si dhe në nenet 126 dhe 306 të Kodit Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Hapjen në orën 14:30 të datës 19.6.2017 të procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k., me përfaqësues ligjor Klejdi Toshkëzi, me seli në Fier, Lushnjë, lagjja Loni Dharmo, përballë “Bar Bullica”.

3. Emërimin si administrator të falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, z. Rrapo Xhaferraj, i licencuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, me nr. 22 licence, datë 1.7.2015, e vlefshme deri në datën 1.7.2017, me adresë: “Hajro Çakëri”, rruga “Sulejman Delvina”, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, të paraqesin pranë administratorit të falimentimit pretendimet e tyre, konform nenit 141, të ligjit 8901, datë 23.5.2002, të ndryshuar, brenda 30 ditëve, nga dita e shpalljes së këtij vendimi.



5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, të njoftojnë menjëherë administratorin e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, duhet t'ia paguajnë dhe t'ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë për verifikim, të mbahet brenda 50 ditëve nga përfundimi i afatit për depozitimin e pretendimeve.

8. Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, duke i dërguar një kopje të tij Buletinit të Njoftimeve Publike.

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, t'i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë t'i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me qëllim njoftimin për të gjitha ZVRPP-të dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 "Për falimentin".

11. Një kopje e këtij vendimi gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, t'u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të RSH-së.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, t'i dërgohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, t'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

14. Të bëhet publikimi i vendimit gjyqësor për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë Balkan Company sh.p.k. Lushnjë, në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organit tatimor Fier e Lushnjë.

15. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të debitorit, shoqërisë Balkan Company sh.p.k., Lushnjë.

16. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë, sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, të ndryshuar.

U shpall në Lushnjë, sot në datën 19.6.2017.

GJYQTARE
Saemira Hila

**PËR PUBLIKIM NË BULETININ E NJOFTIMEVE ZYRTARE TË REGJISTRIT TË VENDIMEVE, TË CILAT KANË NJOHUR
TË DREJTËN PËR KOMPENSIM DHE VLERËSIMET PËR VITIN 1993, 1994 DHE 1995**

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017